



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2018:040534

Datë: 30.07.2019

Numri i dokumentit: 00435189

**P.nr.888/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**-Departamenti i përgjithshëm, sipas gjyqtari Shaqë Curri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku në lëndën penale kundër të pandehurve R L dhe A G, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje pylli, nga neni 358 par.2, lidhur me par.1, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/II.nr. 1826/16, të dt. 24.08.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.29.07.2019, në prani të Prokurores se shtetit Suada Hamza, të pandehurve R L dhe A G, si dhe të dëmtuarit A Q, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.30.07.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Ndaj të pandehurve:**

**R L, i biri i I dhe nënës RR, e gjinisë D, i lindur me dt. ..., në fsh. P, P, K.Pejë, me vendbanim në fsh. V, R .. , K. Pejë, identifikohet në bazë të lnj.nr. personal .., ka të kryer shkollën mesme teknike, me profesion-kuzhinier, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon tel.nr. ... shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.**

**A G, i biri i M dhe nënës N, e gjinisë R, i lindur me dt..., në Istog, me vendbanim në fsh. S, K. Pejë, identifikohet në bazë të lnj.nr. personal ..., ka të kryer 5 klasë të shkollës fillore, punëtor fizik, i martuar, baba i 1 fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon tel.nr. ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.**

Konform nenit 363 par.1 nën par 1.1të KPPK-së.

**REFUZOHET - Aktakuza**

## Gjëja se:

Me dt. 04.08.2016, rreth orës 11:30 min, në fsh. P, R-Pejë, me qëllim të vjedhjes dhe në bashkëveprim të pandehurit kanë bërë prerjen e trungjeve në pronën e të dëmtuarit A Q, nga fsh. D, K. Pejë, në atë mënyrë që të njëjtit kishin shkuar në vendin e cekur më lartë duke prerë dru me motor sharrë dhe me trakto për bartjen e kësaj mase drunore dhe sapo ka vërejtur i dëmtuar se po dëgjohen krisma të motorsharrës shkon në pronën e tij dhe i has të pandehurit ku edhe i fotografon, sasia e drunjëve të prera është në vëllim prej 16.413 m3.

- me çka në bashkëveprim kishin për të kryer veprën penale, vjedhja e pyllit nga neni 358 par 2, lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31, të KPRK -së.

Për shkak të heqjes dorë të prokurorit të shtetit nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barre të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

I dëmtuari A Q, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## A r s y e t i m

Me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1826/16, të dt. 24.08.2016, të pandehurit R L dhe A G, të akuzuar për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e pyllit, nga neni 358 par.2, lidhur me par.1, e lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën për shqyrtimin gjyqësor me datë 29.07.2019, ne te cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit Suada Hamza, të pandehurit R L, A G dhe i dëmtuari A Q.

Pas shqyrtimit të provave ne fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit ndër të tjera ka deklaruar se pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor nuk kemi mundur të vërtetojmë se këtu dy të pandehurit R L dhe A G, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale e cila iu vihet në barrë. Kjo për faktin se i dëmtuari A sa i përket të pandehurit R deklaroi se nuk jam i sigurt se a ka qenë ky person atë ditë, ndërsa fotografitë të cilat i ka deponuar në shkresat e lëndës, edhe vet tregon se i ka realizuar jashtë pronës së tij, respektivisht pyllit të tij. Gjithashtu i dëmtuari A mungesën e drunjëve nga prona e tij e ka vërejtur pas tri ditëve prej ngjarjes kritike dhe deklaroi se nuk e ka parë se kush i ka marr ato drunjë. Të pandehurit kategorikisht kundërshtojnë ti kenë marr drunjë për të cilat po pretendon pala e dëmtuar. Nuk e kontestojmë faktin se ditën kritike kanë qenë në pyllin e tyre dhe që kanë biseduar me të dëmtuarin, sepse edhe të njëjtit e kishin problemin e njëjtë, ngase dikush iu kishte marr drunjë edhe nga prona e tyre. Por kjo nuk e vërteton faktin se këta janë kryes të veprës penale në dëm të dëmtuarit A. Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe duke u thirrur në parimin in dubio pro reo, tërhiqet nga ndjekja penale kundër të pandehurve R L dhe A G, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer veprën penale vjedhje pylli, nga neni 358 par.2, lidhur me par.1, lidhur me nenin 31, të

KPRK-së, e sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/II.nr. 1826/16, të dt. 24.08.2017. meqenëse në asnjë provë nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë me të cilën do të vërtetohet përgjegjësia e dy të pandehurve të lartcekur për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 363 par.1 nënpar 1.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse prokurorja e shtetit hoqi dorë nga aktakuza PP/II.nr. 1826/16, të dt. 24.08.2016 dhe nga ndjekja penale ndaj të pandehurve R L dhe A G.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Konform nenit 463 par 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike i dëmtuari A Q, udhëzohet në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE PEJE, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM**  
**P.nr.888/17 me datë 30.07.2019**

**Sekretarja Juridike**

**Gjyqtari**

\_\_\_\_\_  
Fitore Bojku

\_\_\_\_\_  
Shaqë Curri

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.